



REPUBLIKA E SHQIPËRISE
SH. A UJËSJELLËS – KANALIZIME CËRRRIK

Nr ____ Prot

Cërrrik 17.07.2020

FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT

Për: [Petrit Lika, Elbasan, Bradashesh, Katundi i Ri] [17.07.2020]

Procedura e prokurimit: **Kerkese per propozim**

Numri i referencës së procedurës/lotit: **REF-60810-06-09-2020**

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [Blerje Hipoklorit Natriumi]

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [15.06.2020] [35]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët X oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. Operatori Ekonomik **2 AT** me Nr.Nipt **K14019001H** me oferte me vlere, **780665** (shtateqind e tetedhjetë mijë e gjashtëqind e gjashtedhjetë e pese) leke pa TVSH.
2. BOE **ALBANIAN DISTRIBUTION CHEM sh.p.k** me Nr.Nipt **L82203011N dhe 2MJ** me nr Nipt **L223190130** me oferte me vlere, **762510** (shtateqind e gjashtedhjetë e dy mijë e peseqind e dhjetë) leke pa TVSH..
3. Operatori Ekonomik **ATLANTIK 3** Sh.p.k me Nr.Nipt **K22218003V** me oferte me vlere, **907750** (nteqind e shtate mijë e shtateqind e pesedhjetë) leke pa TVSH.
4. Operatori Ekonomik **PETRIT LIKA** Sh.p.k me Nr.Nipt **K32628215E** me oferte me vlere, **816975** (teteqind e gjashtembedhjetë mijë e nenteqind e shtatedhjetë e pese) leke pa TVSH

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1 Operatori Ekonomik **2 AT** me Nr.Nipt **K14019001H**

2 BOE **ALBANIAN DISTRIBUTION CHEM .p.k** me Nr.Nipt **L82203011N dhe 2MJ** me nr Nipt **L223190130**

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

1. Operatori Ekonomik **2 AT** me Nr.Nipt **K14019001H** me oferte me vlere, **780665** (shtateqind e tetedhjetë mijë e gjashtëqind e gjashtedhjetë e pese) leke pa TVSH.

1. Në ofertën e paraqitur afati i levrimimit nga OE përcaktohet 150 dite. Në DST përcaktohet afati për lëvrimin e mallit deri më 31.12.2020.

OE sipas përcaktimeve të DST nuk mund të ndryshojë afatet, zerat apo volumnet e mallrave të kerkuara nga Autoriteti Kontraktor.

Për këtë arsye skualifikohet.

2. Në vërtetimin e datës 22.06.2020 e leshur nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve Rezulton se Operatori Ekonomik 2AT ka detyrime për kontributet shoqërore .Sipas nenit 45 te LPP pika 2/d per “Kriteret e skualifikimit të operatorëve ekonomikë” Cdo operator mund te skualifikohet nga procedura ne rastet: d) nuk i ka përmbushur detyrimet për derdhjen e kontributeve të sigurimeve shoqërore, në përputhje me legjislacionin shqiptar ose me dispozitat e zbatueshme në shtetin e origjinës; Po kështu në pikë 3, gërma “b” thuhet: “Autoriteti kontraktor pranon si prova të mjaftueshme, që shmangin përjashtimin e kandidatëve apo ofertuesve për rastet e parashikuara në pikat e mësipërme, këto dokumente: [...] një vërtetim të lëshuar nga organi kompetent, që vërteton se nuk ekzistojnë çështjet e përmendura në pikën 2 shkronjat “d”. 6 Ndërsa në nenin 53, pika 3 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet: “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit...”.

Per kete arsye Komisioni i vleresimit te ofertave vendos te skualifikoje operatorin ekonomik.

2. Operatori Ekonomik **ALBANIAN DISTRIBUTION CHEM** .p.k me Nr.**Nipt L82203011N** me oferte me vlere, 762510 (*shtateqind e gjashtedhjetë e dy mije e peseqind e dhjetë*) leke pa TVSH..

1. OE Albanian Distribution Chem ka paraqitur vertetim nr. 4801/1 Date 09.06.2020 dhe OE 2M-J ka paraqitur vertetim nr. 4800/1 date 09.06.2020 ku percaktohet se operatoret ekonomik nuk kane kontrate per energjine me OSHEE dhe per rjedhoje kane ne total 0 leke detyrime per faturat e energjise elektrike. Dokumenti i leshuar nga OSHEE ne kete rast nuk eshte i vlefshem per arsyet e meposhtme:

a. Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektike lëshon vërtetimet e debisë, bazuar në deklaratimet vullnetare të subjekteve kërkues të kontratave të energjisë elektrike. Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektike evidenton saktësinë e dokumentacionit të paraqitur si më poshtë:

1. Tërësinë e kontratave të deklaruara nga subjekti (në rast se mund të ketë kontrata të tjera të padeklaruara).

2. Kontratat e furnizimit për objektet e tyre, duhet të jenë të tarifuara si private.

3. Kontratat e furnizimit duhet të jenë në emër të subjektit, përveç rasteve kur ato janë ambiente të marra me qira.

Në rast se subjekti ka paraqitur kontrata familjare, Operatori i kërkon këtij të fundit ndryshimin e tarifimit dhe pagesën me faturën e ardhshme të diferencës së cmimit bazuar në 10 legjislacionin në fuqi dhe kontratën e furnizimit me energji elektrike. Të gjithë operatorët që kërkojnë të pajisen me Vërtetimin e Debisë duhet të aplikojnë pranë Qendrave të KNK në të gjithë Shqipërinë dhe lëshimi do të jetë i mundur jo më vonë se pesë ditë pas kërkesës nga subjekti. Mosplotësimi i kriterëve të mësipërme do të rezultojë me moslëshimin e Vërtetimit të Debisë nga Drejtoria Qëndrore ose Drejtoritë Rajonale.

Pra si eshte e mundur qe eshte leshuar nje vertetim i tille ne kushtet kur BOE ne fjale nuk ploteson asnje nga kushtet e mesiperme ose me sakte nuk i deklaron ato.

b. Ne QKB OE Albanian Distribution Chem deklarone se ka seline ne: Tirane Tirane, Rruga e Kavajes, Buka Sh.a nr pasurie 8240, Njesia nr.6.

c. Ne QKB OE 2M-J deklarone se ka ne seline ne : Tirane , Tirane , rruga Thimi Mitko nr.2 pa informuar ne kete rast nese ata furnizohen apo jo me energji ne katin e pare te nderteses apo eshte ne kushtet e shmangies se lidhjes se kontrates apo eshte me qera dhe qeradhenesi paguan si bisnes.

Persa me lart duke qene se Modeli zyrtar i lëshimit të Vërtetimit të Debisë në të gjitha rastet e statusit të Operatorëve përmbledh informacionin përkatës për rastet kur:

1. Konsumatori nuk rezulton debitor në Sistemin e Faturimit.

2. Konsumatori rezulton debitor.

3. Konsumatori rezulton debitor por ka lidhur një aktmarrëveshje për shlyerjen e detyrimeve

me këste.

4. konsumatori rezulton debitor por është në proces ankimimi dhe ankesa është në trajtim nga strukturat e OSHEE-së.

5. Konsumatori rezulton debitor por vlera është e ankimuar në gjykatë.[...]

Vertetimi I paraqitur nuk permbush asnje nga kushtet e mesiperme dhe per kete arsye nuk eshte I vlefshem

2. BOE Albanian Distribution Chem & 2M-J nuk ka paraqitur mostra prane AK deri ditën e zhvillimit të Procedures.

3. OE Albanian Distribution Chem pjese e BOE nuk ka plotesuar kriterin e vendosur nga AK per furnizime te ngjashme ku kërkohej për kapacitetin teknik:

1. Per te provuar pervojen e meparshme operatori ekonomik duhet te paraqese deshmi per furnizime te ngjashme ne nje vlere jo me te ulet se 40% te fondit limit pa TVSH-, te realizuara (nga subjekti juaj) ne tri vitet e fundit financiar nga data e zhvillimit te tenderit.

Per kete rast te paraqiten vërtetime të lëshuara nga një ent publik ose/dhe fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara.

OE Albanian Distribution Chem nuk ka paraqitur dokumentacion per furnizime te ngjashme.

4. OE 2MJ pjese e BOE nuk ka plotesuar kriterin e vendosur nga AK: Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të disponojë të paktën 1 (nje) automjete të përshtatshem, me qëllim transportin e mallrave, të cilët duhet t'i ketë në pronësi ose me qira, dhe për të cilët duhet të paraqesë dokumentacionin përkatës, si më poshtë:

a) Dokumentacion që vërteton pronësinë ose marrjen me qera:

Dokumentacioni që vërteton pronësinë:

- Çertifikata e pronësisë e lëshuar nga institucioni i autorizuar me ligj / Kontrata e shitblerjes ose kontrata e dhurimit / Çdo dokument tjetër me anë të të cilit fitohet e drejta e pronësisë sipas Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë.

Dokumentacioni që vërteton marrjen me qira:

- Kontratë qiraje.

b) Leje qarkullimi e mjetit;

c) Certifikatë e kontrollit teknik të mjeteve rrugore;

d) Policë për sigurimin e detyrueshëm të mjeteve;

e) Certifikate për transport mallrash (e detyrueshme vetëm për mjetet me kapacitet transportues mbi 1.5 ton);

f) Leje drejtimi automjeti, për të paktën 1 (nje) prej punonjësve i cili duhet te jete pjese e listepagesave te akten muajin e fundit

OE 2MJ ne baze te marreveshjes 2 paleshe te bashkepunimit ka marre persiper qe te ofroje kontributin e tij ne realizimin e kontrates ne masen 10 % por nuk ka paraqitur dokumentacion per disponimin e nje automjeti. Ne kete rast kemi te bejme me realizimin e kontrate mallrash dhe OE duhet te disponoje automjet per realizimin e kontrates.

5. OE 2MJ pjese e BOE nuk ka plotesuar kriterin e vendosur nga AK :

Kopje të deklaratave të xhiros vjetore ose vërtetim nga administrata tatimore, për xhiron e realizuar në tre vitet e fundit (2017, 2018, 2019), vlera mesatare e të cilës të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit të këtij Prokurimi. Oe nuk ka paraqitur dokumentacion kualifikues per vertetim xhiro.

OE Albanian Distribution Chem nuk ka plotesuar kriterin e vendosur nga AK per:

Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të ketë të punësuar për periudhën 3-mujore Shkurt - Prill 2020, një staf punonjësish prej minimalisht 2 (dy) persona. Për stafin e punonjësve ofertuesi duhet të paraqesë:

a) Vërtetim për kontributet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore lëshuar nga administrata tatimore;

b) Listëpagesat e deklaruara në organet tatimore për periudhën Shkurt - Prill 2020.

OE Albanian Distribution chem ne baze te marreveshjes 2 paleshe te bashkepunimit ka marre persiper qe te ofroje kontributin e tij ne realizimin e kontrates ne masen 90 %.Operatori Albanian Distribution chem nuk ka paraqitur dokumentacion kualifikues.

Pra persa me lart komisioni i vleresimit te ofertave ka vendosur skualifikimin e operatorit te mesiperm.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë [**Petrit Lika, Elbasan, Bradashesh, Katundi i Ri**] se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej **[816975 (teteqind e gjashtembedhete mije e nenteqind e shtatedhete e pese) leke pa TVSH]**/pikët totale të marra [_____] është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë [**Sh.A. Ujesjelles Kanalizime Cerrik, Elbasan, Cerrik, NjA Gostime, Rruga Gostime-Mollas Km1**] sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 24 oreve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, kontrata do t'i akordohet ofertuesit vijues (**ATLANTIK 3 Sh.p.k me Nr.Nipt K22218003V**) në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej **[907750 (nateqind e shtate mije e shtateqind e pesedhete)pa tvsh]**, siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 26.06.2020

Ankesa: ka ose jo "PO"

(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë 06.07.2020

**TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR
ADMINISTRATORI
Eneo TAÇJA**